

Prof. Dr. Lefter NASI

KOSOVA DHE PROBLEMI KOMBËTAR NË VITET 1941- 1943

Problemi kombëtar i shqiptarëve në ish-Jugosllavi doli në pah dhe me gjithë mprehtësinë e tij me fillimin e Luftës së Dytë Botërore. Në prill të vitit 1941 Jugosllavia u bë objekt i sulmit të shteteve fashiste dhe aleatëve të tyre, ndërsa më 17 prill Komanda e Lartë e saj e ushtrisë u detyrua të nënshkruante aktin e kapitullimit. Pushtimi i Jugosllavisë u shoqërua me copëtimin e saj ndërmjet okupatorëve të ndryshëm, copëtim që synonte të përmbushte lakmitë e pjesëtarëve të bllokut fashist dhe të mbante të lidhur pas tyre shtetet satelitë.

Plani për ndarjen e territoreve të Jugosllavisë u konkretizua në mbledhjen e Vjenës, më 21- 22 prill të atij viti, gjatë bisedimeve ndërmjet ministrit të Punëve të Jashtme të Gjermanisë, F. Ribentrop dhe atij të Italisë, G. Çiano. Copëtimin e përjetuan edhe viset shqiptare në përbërje të ish-mbretërisë jugosllave, të cilat u ndanë midis pushtuesve gjermanë, italianë dhe bullgarë. Në bisedime u theksua se kriteri bazë për përcaktimin e kufijve do të ishte përbërja kombëtare e popullsisë dhe pala italiane doli me kërkesën për aneksimin e territoreve “ku jetonin shqiptarët”.¹ Ajo pushtoi Rrafshin e Dukagjinit; pjesën më të madhe të Rrafshit të Kosovës; territoret në veri-Ulqinin, Tuzin, Plavën e Gucinë, si dhe ato në lindje-Dibrën, Tetovën, Gostivarin, Strugën, Kërçovën dhe një pjesë të viseve rreth liqenit të Prespës. Territoret e pushtuara nga fashizmi italian dhe që iu bashkuan shtetit shqiptar të pushtuar më 1939, zinin një sipërfaqe prej 8 000 km² dhe një popullsi me rreth 800 000 mijë banorë. Trekëndëshi i Mitrovicës, Podujevës dhe Vushtrrisë, për shkak të interesave të industrisë gjermane të luftës për minierën e Trepçës, u përfshi në kuadrin e shtetit kuisling serb dhe u vu nën pushtimin gjerman.

¹ M. Kodra. *Acarimi i marrëdhënieve diplomatike midis Italisë dhe Bullgarisë*; në: Vjetari i Arkivit të Kosovës, Prishtinë, 1974, f. 46.

Në bisedimet e Vjenës, Gjermania mbronte interesat e aleates tjetër të bllokut fashist, ato të Bullgarisë, e cila aneksoi një pjesë të rretheve të Gjilanit e të Ferizajt, Vitinë, Kaçanikun, rajone të Preshevës, të Kumanovës e Shkupit etj, ku “jetonin rreth 200 000 shqiptarë”. Ky copëtim, me pak ndryshime, u ruajt deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Por, plani i pushtuesve italianë për ta paraqitur këtë bashkim si përmbushje të ëndrrës së shqiptarëve, me gjithë synimet e qeveritarëve të Romës, përfundoi me “bashkimin” e një pjese të territoreve që iu shkëputën Shqipërisë më 1913 me vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër.

Pushtimi dhe copëtimi i Jugosllavisë krijoi një situatë të re për viset shqiptare që ishin aneksuar në kuadrin e atij shteti dhe për PKJ që u bë forcë kryesore drejtuese e luftës së armatosur të popujve të atij vendi dhe për viset shqiptare të aneksuara në kuadrin e atij shteti. PKJ, që në fillim deklaroi se nuk i njëjthe kufijtë e vendosur nga fashizmi, sepse me ta ishte copëtuat atdheu i komunistëve jugosllavë. Ajo shpalli se do të luftonte për ringritjen e shtetit jugosllav në kufijtë e paraluftës, përpunoi platformën për organizimin e luftës kundër pushtuesve dhe për trajtimin e problemit kombëtar, probleme që për specifikat e ish-jugosllavisë, si shtet shumëkombësh, u lidhën ngushtë me njëri-tjetrin.

Me qëndrimet dhe politikën e PKJ u pajtua edhe udhëheqja e PKSH. Rol të rëndësishëm për këtë laujtën emisarët jugosllavë, të cilët morën pjesë në mbledhjen për themelimin e PKSH dhe qëndruan pranë udhëheqjes së lartë të asaj gjatë gjithë viteve të luftës. Nëpërmjet tyre e të tjerëve që erdhën herë pas here në Shqipëri, letrave e direktivave, PKJ kërkoi nga PKSH të miratonte platformën e saj për trajtimin e problemit kombëtar, vijën politike, të drejtimit dhe strukturën e saj organizative. Organizata e partisë dhe lufta e armatosur kundër pushtuesit në Kosovë e në viset e tjera shqiptare duhej të viheshin nën varësinë e PKJ.

Miratimi i këtyre qëndrimeve, nënvizon E. Hoxha, u bë ngaqë duhej ruajtur struktura e mëparshme e ndërtimit dhe e funksionimit të PKJ. Në të kundërtën Jugosllavia do të dezintegrohej dhe krahinat e përfshira në ish-mbretërinë jugosllave do të shkëputeshin. Sipas tij, kjo duhej evituar me çdo kusht, duhej pranuar statusi i mëparshëm i PKJ dhe duhej pasur kujdes që ky status të ruhej.² Ajo që nuk mund të pranohej për popujt e tjerë, s’mund të lejohej as për Kosovën dhe shqiptarët nuk duhej të bënin gabimin që kishte bërë organizata e partisë në Maqedoni, e cila kishte ndërprerë lidhjet me KQ të PKJ dhe ishte lidhur me PK të Bullgarisë. Këto pohime janë konsideruar si platformë apo qëndrime largpamëse të PKSH, i hasim vetëm në kujtimet e shkruara nga E. Hoxha

² E. Hoxha. *Titistët (shënime historike)*, Tiranë, 1982, f. 69.

40 vjet më vonë, por në asnjë prej shkrimeve dhe në dokumentet e mbledhjeve të asaj partie në vitet e luftës. Ato i përkasin një kohe kur vetë roli i E. Hoxhës, siç del qartë nga materialet e Plenumit të Beratit, ishte larg rolit të drejtuesit kryesor të PKSH, detyrës së protagonistit, të frymëzuesit të qëndrimeve, rol që pretendon dhe i atribuon vetes shumë vite më pas.

Në thelb, problemi i Kosovës dhe i viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi ishte i ndryshëm nga ai i Sllovenisë, i Kroacisë, i Bosnjë-Hercegovinës, i Malit të Zi, Serbisë etj. popujt e të cilëve, pavarësisht nga dallimet, i takonin trungut etnik sllav. Shqiptarët jetojnë në një rajon të përcaktuar qartë gjeografikisht, përgjatë kufirit me shtetin amtar, janë kompaktë e homogjenë në trojet e tyre. Ata janë pjesë e popullit shqiptar dhe përbëjnë gjysmën e tij, që padrejtësisht kishte mbetur jashtë përbërjes së shtetit kombëtar. Përfshirja në kuadrin e ish-Jugosllavisë u shoqërua me zbatimin e politikës së shfarosjes fizike, çka vuri në pikëpyetje ekzistencën e tyre si komb.

Gjatë luftës PKJ kërkoi dhe mori përsipër drejtimin e luftës e të forumeve në Kosovë dhe në viset e tjera, ku shumicën dërrmuese të popullsisë e përbënin shqiptarët. Kështu, luftën e popullit shqiptar, që në shumicën e dërrmuese të tij ra nën sundimin italian, duhej ta drejtonin dy parti, PKSH dhe PKJ.

Është fakt se parimet dhe vendimet e shteteve kryesore të koalicionit antifashist nuk e lejonin PKSH që bashkimin e Kosovës me Shqipërinë ta konsideronte fakt të kryer. Por, njëherazi ato nuk e pengonin, që në të mirë dhe në dobi të forcimit të luftës përkrah popujve pjesëtarë të koalicionit antifashist, të kërkonte që organet e partisë, të ushtrisë dhe të pushtetit, të viheshin nën varësinë e organeve analoge të Shqipërisë. Kjo do të ishte në dobi të zgjerimit të luftës së armatosur, do të ndikonte pozitivisht për mënjanimin e hezitimeve e të pasigurisë, do të hapte perspektiva, do të rriste shpresat e shqiptarëve për respektimin në të ardhmen të aspiratave të tyre në bazë të parimeve të shpallura nga aleanca antifashiste.

Por, PKSH pranoi pa mëdyshje zgjidhjet që iu servirën nga udhëheqja e PKJ. Kjo bëri që shqiptarët në ato vise ta shikonin me shqetësim të ardhmen dhe sidomos realizimin e aspiratave të tyre kombëtare. Pranimi i qëndrimeve të imponuara nga PKJ i pengoi shqiptarët të bënin pjesë, nën një drejtim unik e mbarëshqiptar, në një strukturë politike dhe ushtarake, çka do të ndikonte pozitivisht për pjesëmarrjen e tyre në luftë. Shqiptarët në ish-Jugosllavi duhej të bashkoheshin në luftë nën drejtimin e disa komiteteve krahinore, të disa strukturave ushtarake dhe të pushtetit.

Kështu, KK i PKJ në Kosovë i duhej të drejtonte luftën e armatosur në atë trevë, e cila u nda në tri zona pushtimi - italiane, gjermane dhe bullgare. Por, luftën e shqiptarëve në pjesën më të madhe të trevave nën sundimin italian, në Kosovë, në Dibër, Tetovë, Ulqin; në Tuz do ta drejtonin disa komitete krahinore. Në lindje, në Tetovë, Dibër, Gostivar, Kërçovë, Strugë etj. edhe ato nën sundimin italian dhe më në lindje, si në Preshevë etj. ku shqiptarët përbënin shumicën dërrmuese të popullsisë e që ranë nën sundimin bullgar, këtë rol do ta luante KK i Maqedonisë. Në mars të vitit 1943, KK i PKJ për Maqedoninë u shndërrua në PK të Maqedonisë. Ajo parti në mbledhjen e parë të saj Maqedoninë e ndau në pesë zona operative. Zona e parë operative, që përfshinte rajonet ku shqiptarët përbënin shumicën dërrmuese të popullsisë, në saje të qëndrimit të këtyre të fundit, ishin rajoni me lëvizjen më të fuqishme antifashiste në Maqedoni. Por, pavarësisht nga kjo, shqiptarët nuk përfaqësoheshin në KQ të PKM, në Komitetin e partisë së kësaj zone dhe në sekretariatet Tetovë, Gostivar, Mavrovë dhe Kërçovë, Strugë e Dibër. Në viset shqiptare në veri, në Ulqin, Tuz etj. drejtimin e organizatave të partisë e realizonte KK i PKJ për Malin e Zi, Bokën e Sanxhakun. Ky copëzim i drejtimit të luftës nuk i shërbente masivizimit të luftës, aq më pak forcimit të kompaktësisë së shqiptarëve në luftën kundër pushtuesit. Është fakt se kufijtë e vendosur nga pushtuesi PKSH nuk i njohu, sepse sipas saj me këta kufij “ishte copëtuar atdheu i komunistëve jugosllavë”. Për më tepër, ajo theksonte se “zgjerimi i Shqipërisë është parullë e fashizmit dhe e tradhtarëve”, që synonte të ngjallte ndjenjat shoviniste, të forconte armiqësinë me popujt fqinj, jugosllavë e grekë dhe për ta larguar atë nga lufta nacionalçlirimtare.³

Ky qëndrim, që udhëheqjes së PKSH iu imponua nga emisarët jugosllavë u miratua nga udhëheqja e saj e ngushtë. Ai nuk u mirëprit nga të gjithë drejtuesit e asaj partie, nga komunistët shqiptarë që vepronin në ato vise, të cilët gjykonin se lufta e armatosur duhej të udhëhiqej nga forumet që vepronin në Shqipëri. Aq më pak, këto qëndrime nuk u miratuan nga qarqet dhe forcat e tjera politike që aspironin për bashkimin e trojeve shqiptare në një shtet kombëtar.

Komunistët kosovarë, që në fillim të rezistencës antifashiste iu bënë thirrje aspiratave kombëtare të shqiptarëve, të cilët përbënin shumicën dërrmuese të popullsisë në ato treva. Ata u vunë në ballë të demonstratave antifashiste që u organizuan gjatë muajve nëntor të viteve 1941 e 1942, për të përkujtuar shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, aksione këto që nuk u miratuan nga komunistët serbë e malazezë, sepse sipas tyre përkujtimi i ngjarjeve madhore nga historia e popullit shqiptar

³ Po aty, f. 72 -74.

do të thoshte që të pranohej që këto vise i takonin Shqipërisë dhe duhej t'i ktheheshin asaj. Për ta, krentimi i këtyre festave ishte në shërbim të synimeve të okupatorëve që realizuan copëtimin e Jugosllavisë, të cilën e quanin mburojë të Ballkanit, flamurtare të luftës antifashiste të popujve të tij e më gjerë.⁴

Komunistët me origjinë nga Kosova e kishin të vështirë të pranonin urdhrin për t'u inkuadruar në radhët e PKJ. Një pjesë e tyre, ndonëse u detyruan ta pranonin këtë urdhër, nuk mundën të pajtoheshin me faktin që thirrjet drejtuar popullit shqiptar të mbanin firmën e PKJ, sepse emri i Jugosllavisë ishte i urryer për masat e gjera të popullsisë. Sipas tyre, përmendja e emrit të Jugosllavisë nuk i sillte dobi zgjerimit të luftës, por përkundrazi ndikonte për largim të popullit shqiptar nga lëvizja antifashiste. Në gjykimin e fundit, për shumicën dërrmuese të shqiptarëve përdorimi i emrit të Jugosllavisë në nënshkrimin e thirrjeve e trakteve nënkuptonte përcaktimin e kuñirrit ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Në nëntor të vitit 1941, Komiteti lokal i organizatës së partisë në Mitrovicë e vinte në dijeni Komitetin Krahinor, se me rastin e 28 Nëntorit kishin vendosur të nxirrnin një trakt drejtuar popullit shqiptar, por e shikonin të pamundur nënshkrimin e tij në emër të PKJ, sepse kështu do t'i humbisnin dhe nuk do t'i fitonin masat e gjera.⁵

Në vitet e para dhe deri nga fillimi i vitit 1943, përdorimi i emrit të PK të Jugosllavisë shikohej i vështirë për t'u përdorur edhe nga organizatat e partisë në Prizren, Prishtinë etj, ndërsa traktet e lëshuara nga organizata e partisë në Gjakovë e në Pejë mbanin nënshkrimin Komiteti lokal i partisë për Gjakovë, Rekë e Podrimë dhe Komiteti lokal për Pejë, Istog e Drenicë.⁶

Reagimet dhe mospajtimet e disa prej komunistëve shqiptarë nga ato treva për t'u vënë nën varësinë PKJ ishin objekt i kritikave në mbledhjet e KK të Kosovës, në Vitomiricë, Gërbole, Vrellë, ku u akuzuan për irredentizëm dhe se kishin rënë në pozitat e masave, ndonëse ishin orientuar nga PKSH se në ato troje "do të ishin anëtarë të PKJ dhe se për punën e tyre duhej t'u përgjigjeshin organizatave dhe forumeve udhëheqëse të asaj partie". Për këtë arsye, në pranverën e vitit

⁴ Arkivi i Kosovës, Fondi Komiteti Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës (më tej: AKK i LKK), Stenogram III, f. 478.

⁵ *Zbornik dokumenata i podataka o narodnooslobodilačkom ratu Jugoslovenskih naroda: Borba na Kosovu, 1941-1944*, tom 1, knj. 19 Beograd, 1969, dok. 3.

⁶ AQSH Fondi 14, lista 1, dos. 135, fl. 3; Po any, Fondi 252, v. 1942, dos. 1632, f. 153; Po any, f. 235; Po any, Fondi 253, v. 1942, dos. 179, f. 13; Po any, Fondi 254, v. 1943, dos. 146, f. 115; Po any, Fondi 253, v. 1942, dos. 262, f. 62. Shih edhe: A. Hadri, *Gjakova në Lëvizjen Nacionalçlirimtare*, Prishtinë, 1974, f. 80.

Zbornik dokumenata i podataka ... vep. e perm. f. 475 dhe 543.

1942, nga PKSH u refuzua kërkesa e Shuaip Mustafës, Abdullah Krashnicës dhe Jahja Osmanit, të cilët kërkuan që organizatat e partisë në Tetovë, Gostivar, Dibër, Kërçovë e Strugë të lidheshin me PKSH. Nga drejtuesit maqedonas kjo kërkesë u kualifikua si nacionaliste, ndërsa Komiteti i Tetovës i PKJ e përjashtoi Shuaip Mustafën nga radhët e veta.⁸ Qëndrimi i PKSH për çështjen kombëtare dhe vënia e organizatës së partisë në Kosovë nën varësinë e PKJ ndeshi në kundërshtimin edhe të disa prej komunistëve brenda radhëve të saj. Duke u ndalur në politikën e ndjekur nga PKSH në fillimet e veprimtarisë së saj dhe në rrjedhojat e këtij qëndrimi, Koço Tashkoja, në shtator 1942, në letrën që përgatiti për Kominternin shkruante se “për shqiptarët e Kosovës që përbëjnë 60 – 65 % të popullsisë së atjeshme dhe 2/3 të popullsisë së Shqipërisë së vjetër (kufijve të 1913–ës), Partia ka heshtur sistematikisht duke thënë (fjalët e shokut Miladin), se kjo çështje s’na përket neve po i përket PKJ”.⁹ Rezultati ka qenë se armiku i ka pasur duart e lira. Zgjidhja jonë për çështjen e Kosovës dhe heshtja jonë janë përdorur për të larguar popullin e nacionalistët nga PKSH. Anëtarët e partisë s’kanë qenë në gjendje t’i kundërvihën propagandës së shtypit fashist që shkruan gati çdo ditë për këtë problem, por edhe “nacionalistëve që kërkojnë shpjegime dhe ne s’kemi pasur ç’tu themi konkretisht”.¹⁰ Ai nënvizonte se “s’di që dy parti komuniste të shpallen në një vend”, gjë që i linte dorë të lirë armikut, ndërsa qëndrimi e heshtja jonë për çështjen e Kosovës u shfrytëzuan për të larguar popullin dhe nacionalistët nga PKSH.¹¹

Atë që u prit me rezerva, në Kosovë e Shqipëri u përpoq ta tejkalonte KQ i PKSH. Ai, më 25 mars të vitit 1942, në thirrjen e përbashkët me KK të PKJ për Kosovën i ftonte popujt “për t’u bashkuar në luftë kundër okupatorit” nën udhëheqjen e PKJ. Në 10 parullat me të cilat mbyllej trakti, 5 prej tyre vlerësonin rolin e Bashkimit Sovjetik, të Ushtrisë së Kuqe dhe të Stalinit, 4 të tjera Jugosllavinë dhe Internacionalen komuniste dhe 1 PKSH.¹² Kjo frymë mbizotëroi në traktet e shpërndara nga KK i PKJ për Kosovën e Metohinë gjatë gjithë vitit 1942.¹³ Nxjerrja e këtyre trakteve, nënshkrimi i tyre nga PKSH dhe KK i Kosovës, përmbytja e tyre me elozhe për komunizmin dhe ku injorohej problemi kombëtar, nuk mund të ngjallnin optimizëm tek

⁸ M. Kodra. *Albanska narodnost u organizacijama KPM i organima NOP-a 1941 – 1943*, në Vjetari XXI-XXII, Prishtinë, 1986, f. 215.

⁹ *AQSH*. Fondi 14, lis. 1. Letër e Koço Tashkos drejtuar Kominternit.

¹⁰ *Po aty*.

¹¹ *Po aty*.

¹² *AQSH*. Fondi 266, viti 1942, dos. 67, f. 2.

¹³ *Po aty*. Fondi 14, lis. 1, dos. 135. fl.7. *Po aty*, fl. 15.

shqiptarët. Kundërshtarët e komunizmit ato i konsideruan si dëshmi që "komunistët e Shqipërisë ia kanë lënë Kosovën Serbisë."¹⁴

Mungesa e një platforme për trajtimin e problemit kombëtar dhe miratimi nga PKSH i vijës politike të PKJ, nuk mund të ndikoni pozitivisht për zgjerimin e luftës së armatosur në ato treva. Për më tepër, në ato vite për vetë rrethanat që u krijuan, ky problem u ishte imponuar më shumë se kurrë të gjitha forcave politike, opinionit dhe shtypit shqiptar të kohës. Për këtë arsye, PKSH, me ose pa dashjen e saj, iu desh t'i rikthehej disa herë trajtimit të këtij problemi dhe sidomos më me hollësi, në shtator të vitit 1942, gjatë përgatitjeve dhe zhvillimit të Konferencës së Pezës. Në Konferencë mori pjesë delegacioni i PKSH, i cili përfaqësonte një forcë politike të organizuar, nacionalistë që ishin për luftë kundër pushtuesit fashist; drejtues çetash nacionaliste, elementë me një të kaluar të pasur historike, nacionalistë që dolën kundër pushtimit dhe që më pas aderuan në radhët e organizatës së Ballit Kombëtar. Të gjithë këta, ndonëse ishin personalitete të njohura në jetën politike shqiptare, u përzgjedhën nga organizatorët dhe nuk ishin aktorë kryesorë në procesin e vendimmarrjes, sepse ata vinin në Konferencë si individë me pikëpamjet e tyre politike. Nga organizatorët nuk u thirrën as shumë prej krerëve e drejtuesve të njësiteve të armatosura, të cilët u përmendën edhe në Rezolutën e Konferencës, çka sigurisht që e ngushtonte bazën e frontit si organ më përfaqësues antifashist, por e ndihmonte PKSH për të siguruar rolin drejtues në rezistencën e armatosur.

Delegacioni i PKSH në konferencë i druhej faktit se nacionalistët do ta hapnin problemin e Kosovës.¹⁵ Për këtë arsye, në prag të Konferencës M. Popoviq do të deklaronte prerazi se, "kjo është puna e PK të Jugosllavisë dhe ne s'kemi pse të ngatërrohemi dhe s'mund të lejohet që të ngatërrohemi... Kominterni ka vendosur që çështja e Kosovës është një çështje që do të zgjidhet vetëm prej Jugosllavisë demokratike dhe Shqipërisë demokratike... Për Kosovën është më mirë të rrijë nën PK Jugosllave, se Jugosllavia ka për t'u çliruar më parë se Shqipëria."¹⁶ Nën këtë presion, pohonte K. Tashkoja, ndonjë anëtar i KQ të PKSH do të shprehej se "për shqiptarët e Shqipërisë së vjetër problemi i Kosovës nuk ekziston, çka s'i përgjigjej së vërtetës, por justifikonte dorëheqjen tonë."¹⁷

Pavarësisht nga përpjekjet e emisarit jugosllav, në Konferencën e Pezës çështja e Kosovës nuk mund të anashkalohej, dhe, siç edhe pritej,

¹⁴ AQSH. Fondi 266, viti 1942, dos. 67, f. 2. Shih dhe: AQP. Letër e K. Tashkosh për Kominternin

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Po aty.

ajo u ngrit nga elementët nacionalistë. Nën presionin e tyre u pranua se problemi i Kosovës do të zgjidhej në fund të luftës, nëpërmjet zbatimit të parimit të vetëvendosjes së popujve, ashtu siç ishte parashikuar edhe nga vendet pjesëmarrëse të aleancës antifashiste dhe nga Karta e Atlantikut. Populli i Kosovës do të ndihmohej në përpjekjet e tij për të formuar Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar,¹⁸ i cili do të punonte për bashkimin e popujve të asaj treve në luftë. Delegatët shfrytëzuan opsionin e paraqitur nga aleanca antifashiste, edhe pse emisarët jugosllavë u përpoqën me të gjitha mënyrat që të ushqenin idenë se përpjekjet për trajtimin e problemit të Kosovës jashtë kornizave të përcaktuara prej tyre ishin të rrezikshme, sepse krijonte argumente për identifikimin e LANÇSH me politikën e pushtuesve fashistë.

Në Rezolutën që miratoi Konferenca u nënvizua se do të luftohej për një Shqipëri të lirë, të pandashme, independente dhe demokratike. Këto padyshim që ishin parime të njohura e universale, por konceptimi që pjesëmarrësit e mbledhjes u bënin këtyre parimeve në Rezolutën e Konferencës nuk mund dhe nuk ishte i njëjtë. Në këtë kontekst, ka kuptim edhe formulimi në Rezolutën e Konferencës se do të luftohej edhe për një “Shqipëri të pandashme”, çka nuk është përmendur e sqaruar asnjëherë në literaturën historiografike shqiptare. Siç dëshmon qartë edhe K. Tashkoja, delegatët nacionalistë në Konferencë theksuan se me “Shqipërinë e pandashme s’mund të kuptojnë veç Shqipërinë e kufijve të reja.”¹⁹

Rezoluta dhe vendimet e Konferencës së Pezës patën jehonë dhe u mirëpritën edhe në Kosovë. Gazeta “Liria”, organ i LANÇI, në një nga numrat e vitit 1943, nënvizonte se Konferenca e Këshillit Nacionalçlirimtar të Shqipërisë i mobilizoi edhe më tepër forcat lirishtetërore të popullit shqiptar në këtë luftë çlirimtare, se ka ardhur “koha kur secili popull ka për të vendosur për fatin e vet, se edhe ne shqiptarët e Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit duhet të mendojmë më shumë se kurrë për fatin tonë.”²⁰

Dokumentacioni i kohës dëshmon qartë se problemi i të ardhmes së Kosovës zuri vend në materialet e Konferencës së Pezës, sepse u ngrit nga përfaqësuesit e qarqeve nacionaliste në funksion të bashkimit të mbarë popullit shqiptar në luftë, ndërsa nga forumet drejtuese të PKSH vazhdoi të injorohej. Ai nuk gjeti pasqyrim në evenimentet më të rëndësishme, si në nëntor 1941, në mbledhjen për themelimin e PKSH; në prill 1942, në Konsultën e aktivitetit të PKSH; në mars 1943, në

¹⁸ AQSH. Nga Arkivi i AQP. Rezolucioni i Konferencës së Pezës.

¹⁹ AQSS. Fondi 14, lis. 1. Letër e K. Tashkos drejtuar Kominternit.

²⁰ Liria, organ i LANÇI të Kosovës, gusht-shtator 1943.

Konferencën I të Vendit të PKSH; në maj 1944, në plenumin e PKSH që u mbajt në Helmës; në nëntor 1944, në plenumin e PKSH të mbajtur në Berat. Në Konferencën I të Vendit të PKSH, që përbën ngjarjen më të rëndësishme të asaj partie, nga themelimi deri në Plenumin e Beratit, ndonëse u mbajtën 6 referate për çështje të ndryshme të luftës dhe nga ndonjë pjesëmarrës u insistua që të jepeshin më shumë sqarime për çështjen e Kosovës “që të dimë të përgjigjemi”,²¹ kjo çështje u anashkalua dhe nuk u diskutua fare. Aty fjala e emisarëve jugosllavë ishte vendimtare, sepse ata ishin ndër përgatitësit e Konferencës, u zgjodhën në kryesinë e saj dhe morën përsipër dhe bënë konkluzionet pas çdo referati.²²

Pavarësisht heshtjes që mbajtën forumet, problemi kombëtar ishte dhe mbeti gjithnjë i pranishëm dhe ai iu imponua udhëheqjes së PKSH, forumeve të lëvizjes nacionalçlirimtare dhe emisarëve jugosllavë. Për shkak të trysnisë së qarqeve politike shqiptare, të pengesave që kjo politikë i krijonte forcimit të lëvizjes nacionalçlirimtare në Kosovë, M. Popoviq në letrën dërguar udhëheqjes më të lartë të PKJ kërkonte konfirmimin e J.B. Titos për qëndrimin që kishte adaptuar në politikën e PKSH dhe një prononcim të qartë të tij për problemin e Kosovës. Këto kërkesa M. Popoviq ia kishte shtruar në korrik të vitit 1943 edhe Ivan Milutinoviçit, të dërguarit të KQ të PKJ në Mal të Zi. Emisari jugosllav pranë udhëheqjes së PKSH, sugjeronte që çështja e Kosovës të shtrohej sipas shembullit të Istriës e të bregdetit slloven dhe propozonte që për zgjerimin e lëvizjes së armatosur në atë trevë, Rrafshi i Dukagjinit, në pikëpamje të drejtimit të partisë të vihej nën varësinë e PKSH. Në atë kohë këtyre propozimeve nuk iu dha përgjigje e menjëhershme dhe nga udhëheqja jugosllave u kërkua largimi i M. Popoviqit nga Shqipëria. Në këto rrethana, M. Popoviq iu drejtua Titos dhe i theksonte se edhe më parë kam kërkuar që “zëvendësimi duhet bërë nga një shok me eksperiencë politike, i cili do të mund të udhëheqë me të vërtetë e të japë vijën e partisë. Ai është më i nevojshëm tashti se kurdoherë më parë, sepse KQ i Shqipërisë ka nevojë absolute për ndihmë dhe ai e pret këtë ndihmë nga PKJ për të cilën ka simpati të pamasë dhe e cila është me autoritet. Dhe ty (Titon) të njohin të gjithë. Më duket se njohin më shumë fjalë të mira për PKJ se sa për PK të Shqipërisë”.²³ Në atë kohë ky largim nuk u realizua, por u shty për më vonë.

²¹ AQSH. Fondi 14, lis. 1, dos. 10. Procesverbali i Konferencës I të Vendit të PKSh, mars 1943., diskutimi i dr. Vasilit (pseudonim)

²² AQSH. Fondi 14, lis. 1, dos. 10, f. 1-2. Procesverbal i Konferencës I të Vendit të PKSh.

²³ AQSH. Fondi 14, list. 1, dos. 91, fl. 6. Letë e M. Popoviqit për Titon.

Preokupimet dhe shqetësimet e të gjithë krahëve të spektrit politik shqiptar zunë vend të veçantë gjatë bisedimeve që u zhvilluan në Mukje, në gusht të vitit 1943, midis delegacioneve të dy organizatave politike, Balli Kombëtar dhe Fronti Nacionalçlirimtar, ku aderuan edhe përkrahësit e monarkisë me në krye A. Kupin. Në bisedime vend të veçantë zuri trajtimi i problemit kombëtar. Në fillim delegacioni i Frontit Nacionalçlirimtar ngurroi të përfaqonte platformën e bashkëbiseduesve në Konferencë, që të luftohej edhe për krijimin e “Shqipërisë etnike”. Miratimi i këtij objekti nuk ishte i lehtë, për ndonjë pjesëmarrës komunist që bënte pjesë në delegacion, i cili do të theksonte se “ nuk e duam Kosovën se na e ka falur armiku..., nuk mund ta kërkojmë Kosovën, sepse vemi në kundërshtim me Kartën e Atlantikut, në të cilën nuk përmendet fjala etnike..., po të kërkojmë Kosovën bëhemi edhe ne si Mustafa Kruja, sepse edhe ai e kërkon Kosovën”.²⁴ Pas diskutimeve të shumta për këtë problem, në mbledhje triumfoi pikëpamja e përfaqësuesve të forcave nacionaliste. Në marrëveshjen e nënshkruar me atë rast u pranua se të gjitha forcat politike do të luftonin për krijimin e Shqipërisë etnike, çka nënkuptonte bashkimin e trojeve shqiptare.²⁵ Aty u vendos për formimin e Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë, me numër të barabartë anëtarësh nga të dy organizatat, një organ që do të bashkërendonte përpjekjet për zbatimin e marrëveshjes.

Vendimet e Konferencës së Mukjes u pritën me indinjatë nga emisarët jugosllavë në Shqipëri, të cilët nuk mund të lejonin që PKSH “të bënte pazarllëk me nacionalizmin shqiptar të tipit nacionalist.” Dëshmitarë okularë pohojnë se M. Popoviq sapo mësoi përmbajtjen e marrëveshjes lëshoi sharjet më të ndyra ndaj “Shqipërisë etnike” dhe ndërhyri pranë PKSH dhe LNÇ për prishjen e saj.²⁶ Ky qëndrim është shprehur qartë edhe në një nga letrat që i dërgoi J. B. Titos. Në të, duke sulmuar e fajësuar A. Kupin, deri në atë kohë anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, ai shkruante se “në Konferencën e Mukjes... ai ka luajtur rolin e arbitrit. Nën ndikimin e tij delegatët tanë u mashtruan dhe ranë në gabimin shovinist për “Shqipërinë etnike”.²⁷

Në këto rrethana, E. Hoxha u distancua nga vendimet e Konferencës së Mukjes dhe akuzoi përfaqësuesit e PKSH, Ymer Dishnica dhe Mustafa Gjinishi, se kishin injoruar udhëzimet e KQ të PKSH. Por këto akuza nuk tingëllojnë bindëse, aq më tepër kur dihet se kryetari i delegacionit të PKSS, Y. Dishnica ishte ndër drejtuesit kryesorë

²⁴ *Flamuri*, viti I, nr.5, 1944. Marrëveshja e Mukjes.

²⁵ *Po aty*.

²⁶ R. Rajoviç. *Autonomia e Kosovës*. Beograd, 1985, f. 293.

²⁷ *AQSH*. Fondi 14, lis. 1, dos. 91, fl. 6/3- 6/5. Letër e M. Popoviqit dërguar J. B. Titos (pa datë).

të PKSH, anëtar i Byrosë Politike të KQ dhe e njohte shumë mirë politikën e partisë dhe të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar që kishte autorizuar pjesëmarrjen e delegacionit në bisedime. Sqarimi i qëndrimit të delegacionit për trajtimin e problemit kombëtar përbënte një pikë shumë të rëndësishme dhe Y. Dishnicës, një ditë pas nënshkrimit të marrëveshjes e në disa letra radhazi paraqiti arsyet që e kishin shtyrë për miratimin e saj, që në thelb nuk ndryshonte nga parrulla e "Shqipërisë së pandashme" që u sanksionua në Konferencën e Pezës.

Ai i shkruante E. Hoxhës se një nga arsyet që e kishin bindur për mbajtjen e këtyre qëndrimeve ishin kërkesat e shtruarat nga elementët antifashistë në Kosovë. Pas takimeve me Ismet Shaqirin (një nga drejtuesit e organizatës së partisë në Rrafshim e Dukagjini- shën. aut.) Y. Dishnicës shkruante se "lëvizja në Kosovë ishte shumë e dobët.... kreu i shkëputur nga masat shqiptare...sepse komunistët konsiderohen të shitur". Ata kishin arritur në konkluzionin se, "duket hapazi se faji nuk është vetëm te shokët, por edhe politika që është ndjekur në Kosovë duhet rishikuar nga themeli". Ai i kujtonte E. Hoxhës se këto duheshim marrë në konsideratë nëse duam që Kosova të lëvizë, të mos bëhet "sot rezervë e Italisë" e "nesër rezervë e reaksionit". Për të parandaluar këtë "duhet një ilac i mirë dhe i shpejtë".²⁴

Rezervat për politikën që ishte ndjekur në Kosovë deri në atë periudhë Y. Dishnicës ia kishin paraqitur edhe Mehmet Hoxha dhe Hasan Kryeziu, të cilët "kërkonin të bashkëpunonin me lëvizjen, por ankoreshim për gjithë vijën, për politikën e jashme në lidhje me aleatët, me fqinjët".²⁵ Ndërkohë, Fuat Dibra dhe Hysni Peja i kishin shfaqur dëshirën që "me disa krerë kosovarë të hynin në kontakt me Shtabin jugosllav për të folur më konkretisht për punët e Kosovës...Të dy kanë frikën e terrorit cetnik; nuk kanë bindje sa duhet në fuqitë nacionalçlirimtare jugosllave... kontaktin me Shtabin jugosllav e presim me shumë qejf dhe bashkëpunimin me komunistët e Kosovës e me me e dëshirojnë shumë".²⁶ Po këto pikëpamje e qëndrime i kishin shprehur edhe Tafil Boletini dhe Seit Kryeziu, "por që të gjithë mendojnë njësoj: Kosovën e quajnë që sot shqiptare".²⁷

Por marrëveshja e Mukjes u prit me nderim të madh edhe nga S. V. Tempo, i cili u njoh me përmbajtjen e saj pas kthimit nga Greqia, dhe pasi e cilësoi si shembull "të deviacionit shqiptaromadhi" kërkoi nga PKSH denoncimin e saj.

²⁴ Po aty, dos. 21, fl. 14-16, Letër e Y. Dishnicës, dt. 3, § 1943.

²⁵ Po aty.

²⁶ Po aty, fl. 23-27, Letër e Y. Dishnicës, dt. 14, § 1943 dërguar KQ të PKSH.

²⁷ Po aty.

Hedhja poshtë e vendimeve të Mukjes nuk ishte një gjë e lehtë dhe e thjeshtë dhe nuk mund të kalonte pa probleme midis forcave politike e shqiptarëve në të dyja anët e kufirit. E. Hoxha në referatin që mbajti në Konferencën II Nacionalçlirimtare, në Labinot në shtator 1943, u detyrua t'i kthehej problemit kombëtar dhe më me detaje. Këto argumente që u përdorën për të hedhur poshtë marrëveshjen e Mukjes në literaturën historike të botuar përpara viteve 90 është theksuar se kanë përbërë vijën e PKSHT për zgjidhjen e problemit kombëtar.

Në referat vendimet e Konferencës së Mukjes që u firmosën edhe nga përfaqësues të lartë të PKSHT u sulmuan me slogane komuniste, kështu që ato nuk bënë tjetër veçse rritën dyshimet dhe shqetësimet midis nacionalistëve. Në të u theksua se “KNÇ ka pasur një vijë të qartë për Kosovën...dhe qëndron tek ajo politikë, se është e drejtë. Lufta jonë Nacionalçlirimtare është luftë popujsh, e përbashkët, krahas me aleatët, kundër boshtit. Aleanca e shëndoshë me luftë e me gjak vlen më tepër se karta. Qëllimi është që tok të bashkuar të ndjekim këtë luftë, duke harruar gjithë të kaluarën, se mbi tokën tonë na turren një armik i njëjtë, masandej ne që kemi luftuar së bashku, me dashurinë më të madhe do t'i ujdësim moskuptimet. Populli shqiptar që ka vuajtur nuk do të skllavërojë e të copëtojë tjetrin që ka vuajtur si ai kësajsoj reciprokisht”.³² Bie në sy se përgjysmimi i popullit shqiptar u trajtua si moskuptim që do të zgjidhej me dashurinë më të madhe; popujt, shqiptar e serb, viheshin në një plan, të dy kishin vuajtur njëlloj dhe duhej të harronin të kaluarën; nuk u fol për të ardhmen e shqiptarëve dhe për të drejtat e tyre, sepse duket se kjo u konsiderua akt skllavërimi e copëtimi në kurriz të popullit serb.

Më pas, vijonte E. Hoxha “...vetë popullsitë mes tyre në Kosovë do të merren vesh dhe do të vendosin nga të shkojnë. LNÇ ka për detyrë ta bëjë popullin e Kosovës të ndërgjegjshëm për aspiratat e tij, duke i thënë se ka për të shpëtuar vetëm me luftë kundër okupatorit fashist dhe okupatorit eventual jugosllav, si Mihajloviqi... ta bëjmë popullin e Kosovës të vendosë vetë nga ka për të vajtur, siç e duam edhe ne dhe të luftojë atë Jugosllavi që do ta skllavërojë”.³³ Sipas kësaj rezultoi se në të ardhmen, pra pas përzënies së pushtuesve fashistë, rezik për Kosovën përbënte vetëm Drazha Mihajloviq dhe rikthimi në pushtet i monarkisë dhe as që mund të mendohej e pranohej se ai mund të vinte nga politika dhe qëndrimi i forumeve politike e ushtarake të lëvizjes nacionalçlirimtare jugosllave.

³² AQSH. Fondi 14, lis. 1, dos . 19. Referat i mbajtur në Konferencën II Nacionalçlirimtare, shtator 1943.

³³ *Po aty. Në dokumentet e përfshira në vëllimin Dokumente të organeve të larta të pushtetit revolucionar nacionalçlirimtar*, (Tiranë, 1962, f. 50) përmbajtja e këtij referati të përfshirë në këtë botim ka mospërputhje me tekstin e origjinalit që ruhet në AQSH.

Këto vlerësime u vunë në themel të Rezolutës së Konferencës, ku u nënvizua se “çështja e Kosovës dhe e Çamërisë do të zgjidhet në bazë të Kartës së Atlantikut; në bazë të parimit të vetëvendosjes së popujve dhe garancia për këtë është lufta e Kosovës dhe e Çamërisë së bashku me popujt jugosllavë e grekë kundër okupatorit italian e gjerman dhe tendencave shoviniste në botë e në Ballkan”.³⁴ Pra, ndërsa në marrëveshjen e Mukjes problemi ishte konkret dhe kërkonte zgjidhje, në Konferencën e Labinotit u mjegullua, u shtri në një kontekst shumë më të gjerë, nuk angazhonte askënd dhe si i tillë mund të shmangej lehtë në të ardhmen.

Ndërsa trajtimi i problemi kombëtar nuk gjeti shprehje në asnjë nga forumet dhe dokumentet themelore të PKSH të kohës së luftës, kjo parti dhe pa miratimin e forumeve të saj, punoi për lidhjen e Shqipërisë me Jugosllavinë. Marrëdhëniet që u krijuan ndërmjet PKSH dhe PKJ nuk ishin thjesht marrëdhënie të fqinjësisë së mirë e të bashkëpunimit, por ato çuan gradualisht në nënshtrimin, më parë të PKSH dhe më pas, me afrimin e mbarimit të luftës, synuan aneksimin e Shqipërisë nga Jugosllavia. Lidhja dhe bashkimi me Jugosllavinë u maskua me “bashkim-vëllazërimin e popujve” dhe me “internacionalizmin proletar”. Bashkimin, sipas projekteve të përgatitura nga drejtuesit komunistë jugosllav, do ta paraprinte krijimi i Shtabit ballkanik dhe më pas do të vijonte me bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë nëpërmjet formimit të Federatës ose Konfederatës ballkanike, të cilat kuptohej që do të udhëhiqeshin nga Jugosllavia komuniste.

Ideja për krijimin e Shtabit ballkanik u artikulua për herë të parë, në pranverën e vitit 1943, nga i dërguari i posaçëm i udhëheqjes së PKJ dhe i Shtabit të UNÇJ në Maqedoni Svetozar Vukmanoviq–Tempo, në takimin që pati me E. Hoxhën e M. Popoviqin, në Labinot të Elbasanit. Sipas tij, ky shtab do të ishte një organizëm me funksione të rëndësishme ushtarake dhe do të përbëhej nga përfaqësues të shtabeve të përgjithshme të të gjitha vendeve ballkanike. E. Hoxha në kujtimet e tij shkruan se kjo ide u rishtrua nga emisari i lartë jugosllav, rreth korrik-gushtit të atij viti në Kucakë të Korçës, por nuk u miratua, sepse u konsiderua e parakohshme.³⁵ Ai pohon se dyshimet që lindën me këtë rast lidhur me mënyrën e organizimit, se prapa idesë së shtabit të përbashkët (Tempo-shën. aut.) shihte mundësinë për ta vënë këtë shtab “nën varësinë e Shtabit jugosllav, pra ushtritë e vendeve të Ballkanit nën varësinë e Jugosllavisë”, shërbyen si shkak për mostrajtimin e këtij problemi në

³⁴ AQSh. Fondi 14, lis. 1, dos. 19, fl. 2. Rezolucion i Konferencës II Nacionalçlirimtare, vjeshtë I, 1943.

³⁵ E. Hoxha. *Titistët*, vep e përm. f. 55.

forumet e PKSHT dhe për të mos e parë me seriozitet këtë çështje. “Bashkë me Tempon aty nga vjeshta, vijojnë kujtimet, u zhduk edhe plani i tij i dështuar dhe asnjëherë nuk u zu në gojë ideja e Shtabit Ballkanik”.³⁶ Por këto pohime nuk mbështeten në dokumentacionin arkivor të kohës, i cili për më tepër dëshmon të kundërtën. Është fakt që kjo ide deri në atë kohë nuk ishte shtruar në asnjë nga forumet e PKSHT. Pavarësisht nga kjo ideja avancoi gjatë muajve në vijim dhe zuri vend në vendimet e forumeve më të rëndësishme të luftës, si edhe midis drejtuesve të njëjsteve partizane të shpërndara në rajone të ndryshme të vendit. Kështu, në rezolutën e Konferencës II Nacionalçlirimtare që u mbajt në Labinot më 1943, pasi bëhej bilanci i arritjeve të lëvizjes, nënvizohej se “është në organizim e sipër një shtab interballkanik”.³⁷ Ndërkohë, më 18 shtator 1943, në përshëndetjen që Mehmet Shehu, komandant i Brigadës I të UNÇSH, u drejtonte partizanëve bullgarë, ndërmjet të tjerave theksohej se “themeli i vëllazërimit të popujve tanë po hidhet me formimin e Shtabit të Përbashkët, Shtabit Partizan Interballkanik, i cili ka për të na udhëhequr me siguri drejt fitores sonë të përbashkët.” Përshëndetja përfundonte me thirrjen “Rroftë Shtabi i Përbashkët Interballkanik!”.³⁸ Nga ana e tij, Isuf Kambo, i cili vepronte në zonën e thellë të Mokrës dhe që mesa duket njihte vendimet e forumeve të lëvizjes, por nuk kishte dijeni për ecurinë e mëtejshme të problemit, në letrën drejtuar Esat Dokos në Strugë shkruante se “lëvizja nacionalçlirimtare e jona ka lidhje të ngushta me anën e Shtabit Interballkanik me të gjitha lëvizjet nacionalçlirimtare të popujve ballkanikë”.³⁹

Në atë kohë, dhe jo për shkak të kundërshtimit të PKSHT por të faktorëve të tjerë, ideja për krijimin e Shtabit ballkanik u hodh poshtë. Përpyekjet e J. B. Titos në këtë ndërmarrje ndeshën në kundërshtimin e Stalinit, çka e detyroi atë të dalë me qëndrime të tjera. Sipas tij, “formimi i çfarëdo shtabi ballkanik në themel është i gabueshëm... Shtabi ballkanik është i pakuptimtë, sepse një shtab i tillë nuk ekziston dhe as që mund të ekzistojë”.⁴⁰ Por pavarësisht nga kjo tërheqje, udhëheqja jugosllave nuk hoqi dorë nga synimet për të dominuar mbi lëvizjen e rezistencës së

³⁶ *Po aty*, f. 55.

³⁷ *AQSH*. Fondi 14, lis. 1, dos. 19, fl. 2-5. Rezolucioni i Konferencës II Nacionalçlirimtare, vjeshtë I, 1943.

³⁸ *Po aty*. Fondi 177, lis. 1, dos. 3, f.1. Përshëndetja e M. Shehut, komandant i Brigadës I për partizanët bullgarë, dt. 18. 9. 1943.

³⁹ *Po aty*. Fondi 43, lis. 1, dos. 7. Letër e I. Kambos nga Mokra për E. Dokon në Strugë, dt. 24. 10. 1943.

⁴⁰ *Zbornik dokumenata...*, vep. e përm. knj. II/11, dok. 104. Cituar sipas I. Hotit, *Çështja e Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Prishtinë, 1997, f. 54.

popujve të Ballkanit dhe mbi shtetet që do të krijoheshin pas mbarimit të luftës.

Falsitetin e ideve për vëllazërimin e popujve, si edhe për kompleksitetin e problemit kombëtar të popullit shqiptar, e dëshmoi qartë politika e ndjekur nga Tempoja dhe nga drejtuesit maqedonas të lëvizjes nacionalçlirimtare në Dibër, në vjeshtën e vitit 1943. Nga shtatori deri në mes të nëntorit Dibra ishte zonë e çliruar. Forcimi i lëvizjes, krijimi i zonës së lirë dhe ngritja e organeve të pushtetit në atë trevë u arrit në radhë të parë në saje të luftës e të kontributit të shqiptarëve. Ata përbënin shumicën dërrmuese të popullsisë dhe pa pjesëmarrjen e tyre në luftë, në strukturat politike, ushtarake e të pushtetit, këto organe nuk mund të jetonin e të vepronin. Por, rritja e pranisë së shqiptarëve në këto struktura nuk shkante në të njëjtin kah me synimet e drejtuesve maqedonas, të cilët trembeshin se rritja e peshës së tyre në këto organe do të ndikonte në përcaktimin e të ardhmes së kësaj treve.

Krerët maqedonas nuk ishin të interesuar aq për forcimin e lëvizjes se sa për faktin se nga komisarët shqiptarë “nuk u përmend emri Maqedoni dhe u fol sikur me pas kenë Shqipëri”.⁴¹ Ata “thonë se Dibra që sot duhet t’i përkasë Shqipërisë”.⁴² Në letrën e S. V. Tempos drejtuar KQ të PKSH më 13 shtator 1943, shprehej shqetësimi se në Dibër “ishte vendosur pushteti shqiptar”, i cili nuk lejonte ngritjen e “flamurit maqedonas”.⁴³ Ai kërkonte nga shtabi partizan i UNÇSH, që “komiteti nacionalçlirimtar t’i këpuste lidhjet me ju dhe të vihej nën komandën e Shtabit madhor” (maqedonas- shën. i aut.), që shtabi i Dibrës “të jepte një çetë për të vendosur rendin në Dibër, deri sa të forcohej pushteti jonë.. e pastaj të tërhiqej jashtë kufirit”.⁴⁴ S. V. Tempoja kërcënonte se “keni borxh ta bëni sa më parë këtë, pse ndryshe do të arrihet në përlëshje me armë midis shqiptarëve e maqedonasve në Dibër, e cila mund të përfshijë edhe komunistët”.⁴⁵ Emisari jugosllav dhe drejtuesit maqedonas pranonin se këto masa do të provokonin kundërshtimin e popullsisë, çka do të çonte në dështimin e partizanëve, sepse pushteti aty nuk mund të organizohej pa pasur më tepër forca, se bajraktarët ishin të rrezikshëm për mbarë Shqipërinë e për ne.⁴⁶ Akuzat dhe kërcënimet e drejtuesve maqedonas e të emisarit jugosllav bëheshin në kohën kur në Shqipëri po zhvillonte punimet Konferenca e Labinotit, vendimet e së cilës për

⁴¹ *Po aty*. Letër e drejtuesve maqedonas për S. V. Tempon, dt. 18. 9. 1943.

⁴² *Po aty...*, dos. 39. Letër e Stevo (Janko), dt. 14. 9. 1943, dërguar KQ të PKSH.

⁴³ *Po aty*. Letër e Tempos për KQ të PKSH, dt. 13. 9. 1943.

⁴⁴ *Po aty*. Fondi 14, list. 1, dos. 39, Letër e S.V. Tempos për M. Popoviqin, dt. 24. 10. 1943.

⁴⁵ *Po aty*.

⁴⁶ *Po aty*, fl. 15. Letër dërguar Tempos, dt. 18. 9. 1943.

vëllazërimin e popujve, për krijimin e shtabit ballkanik ishin shumë larg dhe në antitezë me deklaratimet e kërcënimit e S. V. Tempos e të drejtuesve maqedonas. Në vend të “vëllazërim- bashkimit” këta të fundit kërkonin largimin e reparteve shqiptare dhe shmangien e shqiptarëve nga pjesëmarrja në organet e pushtetit, kërcënonin me përlëshje të armatosura ndërmjet partizanëve, ndonëse pranonin se njësitet maqedonase nuk ishin në gjendje të siguronin funksionimin e pushtetit mbi qytet e rrethinë.

Ndonëse emisari jugosllav kërcënonte dhe me prepotencë shprehu në mënyrë të prerë e të qartë pikëpamjet dhe qëndrimet e PKJ, PKSHT që i kishte duart dhe këmbët të lidhura nuk mund të shprehej për çështjen jetike të popullit shqiptar. E. Hoxha, në letrën drejtuar H. Lleshit, porosiste që çështja e kufijve nuk duhej përmendur, sepse ishte një sëmundje e koklavitur, e cila do të zgjidhej më vonë,⁴⁷ ndërsa S. V. Tempo, në nëntor të atij viti, ai shpejtonte t'i ritheksonte se “kufijtë e rinj që ka caktuar fashizmi ne nuk i pranojmë”.⁴⁸

Në letrën drejtuar M. Popoviqit, Tempoja nënvizonte se problemën e Dibrës ai do t'ia referonte Titos për të vendosur.⁴⁹ Njoftimi për ta informuar J. B. Titon për problemën e kufijve dhe për ta vënë atë në rolin e arbitrit i shqetësoi drejtuesit e PKSHT. Në letrën dërguar E. Hoxhës, Nako Spiru pasi nënvizonte se kjo “asht një çështje delikate..., por them të kesh kujdes”, këshillonte se “duhet të vendosim lidhje miqësore por edhe bashkëpunimi me Maqedoninë”, të “mundohuni të merreni vesh drejtpërdrejt me Tempon”. Sipas tij, kjo ishte çështje delikate dhe Titos, i cili do të vendoste, duhej menduar për t'ia paraqitur sa më mirë problemën.⁵⁰

Me gjithë akuzat kundër partizanëve shqiptarë, emisarët jugosllavë dhe drejtuesit vendorë ishin të detyruar të kërkonin nga PKSHT të dërgonte disa njësi partizane e sa më shumë njerëz të lidhur me lëvizjen nacionalçlirimtare. Në letrën e 6 shtatorit 1943, Fadil Hoxha kërkonte nga PKSHT të dërgonte në Kosovë dy çeta të forta nga Shqipëria, komunistët kosovarë dhe ilegalë të tjerë, në “Zërin e popullit” të përmendnin Kosovën e të shkruanin edhe për ne, se në organizatat tona ankohen nationalistët se gjoja nuk njihemi nga lëvizja nacionalçlirimtare dhe shihemi si agentë të Jugosllavisë.⁵¹ Në prag të Konferencës së Bujanit KK i Kosovës kërkonte nga KQ i PKSHT që deri më 30 dhjetor të “na dërgoni 1 ose 2 përfaqësues, që duhet të marrin pjesë në Konferencën

⁴⁷ E. Hoxha. *Vepra*, vëll. I. Tiranë, 1983, f. 502.

⁴⁸ E. Hoxha. *Titistët*. vep e përm., ... f. 49.

⁴⁹ *AQSH*. Fondi 14, lis. 1, dos. 39, fl. 33/1. Letër e Tempo për M. Popoviqin, dt. 24. 10. 1943.

⁵⁰ *Po aty*, dos. 20, fl. 4-7. Letër e N. Spirit për E. Hoxhën, dt. 8. 10. 1943.

⁵¹ *Po aty*. Fondi 41, lis. 1, dos. 39. Letër e F. Hoxhës për KQ të PKSHT, dt. 6.9 1943.

e Përgjithshme të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit për me formue Këshillin e Përgjithshëm të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit”.⁵² M. Popoviqi në dhjetor e informonte KK se, “prej këtej u kemi dërguar të gjithë shqiptarët që kini kërkuar”.⁵³

Në këtë periudhë, situata e përgjithshme politike e ushtarake ushquu një klimë ku lulëzuan premtime e zhgënjime, dëshira e mashtrime. Me fillimin e kthesës së luftës, kur edhe perspektivat e fitores mbi fashizmin po bëheshin më të qarta e të afërta, çka u dëshmuua sidomos me kapitullimin e fashizmit italian, përfaqësuesit legjitimë të popujve të Kosovës do të përgatisnin e thërrisnin Konferencën Nacionalçlirimtare për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit. Sipas përfaqësuesve të popujve të kësaj treve, të dalë nga radhët e shtresave të lidhura me Luftën Antifashiste, Konferenca sanksionoi në një forum legjitim pozitën e veçantë, të barabartë të Kosovës me atë të trevave të tjera, barazinë e popullit shqiptar me popujt e tjerë të Jugosllavisë, të drejtën e popullit shqiptar për vetëvendosje deri në shkëputje dhe për bashkim kombëtar që buronte nga karakteri i luftës. Në marrjen e këtyre vendimeve shqiptarët u bazuan edhe në premtimet e J. B. Titos, i cili në vitin 1942 në gazetën “Proleter”, ku shqiptarëve iu premtuan të drejta të barabarta me popujt e tjerë të atij shteti, problemi i Kosovës dhe i popullit shqiptar ishte i njëjtë me atë të popujve e të krahinave të tjera të Jugosllavisë, Kosova ishte trajtuar si njësi e veçantë dhe e barabartë me trevat e tjera.

Në këtë mënyrë, viti 1943 u mbyll me shpresa e zhgënjime për shqiptarët, ndërsa gjatë periudhës pasardhëse u rritën shpresat e vendeve të koalicionit antifashist dhe të drejtuesve të lëvizjeve nacionalçlirimtare për fundin e pushtuesve fashisë. PKJ do të nxjerrë dhe do të hedhë në tavolinë synimet e hershme e të njohura mbi trojet shqiptare.

⁵² *Po uty*. Letër e Rades për KQ të PKSH, dt. 22. 11. 1943.

⁵³ *Zbornik dokumenata...*, vep. e përm. knj. 19, dok. Letër e Miladin Popoviqit për Pavle Joviçeviqin.

Prof. Dr. Lefter NASI

SUMMARY

KOSOVA AND NATIONAL QUESTION IN PERIOD BETWEEN 1941 AND 1943

Albanian national question in Yugoslavia re-emerged as an issue demanding solution in time of global conflict and confrontation. During this confrontation biggest part of Albanian lands was under Italian subordination and in August 1941, Italy united them to Albania.

Unification with homeland brought the realization of a longtime Albanian dream, but CPA (Communist Party of Albania) did not accept this reality of the time. Disapproval of Kosova and other Albanian regions unification to homeland showed clearly that this party had no platform of national approach in a time, when premises were in place. As a CPY (Communist Party of Yugoslavia) branch party, it feared nationalist forces which ideal was aiming the national unification.

Also, by faithfully embracing CPY principles, in preserving Old Yugoslavia, on its own meetings and forums, it avoided the question of Kosova and other Albanian parts. Thus, CPA under brotherhood-union veil with Slavic nations and praising with glory Soviet Union left aside the major national issue.